PROCESVERBAL I MBLEDHJES DATE 30.06.2025

Prezent:Alfredi Gjata, Valbona Spaho, Imelda Cucka, Oljanq Comka, Arsina Mazelliu, Kledi Cenkolli, Oliver Mulla, Lindita Cokani, Albana Skoti, Giela Hoxhalli, Vladimir Kello, Ilir Hoxha.

Alfredi Gjata:: Vazhdojme me piken 1, miratimi i rendit te dites

Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim

Alfredi Gjata:: Vazhdojme me piken 2: Miratimi i procesverbalit te dates 30.05.2025

Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim

Alfredi Gjata:: Vazhdojme me piken 3, **P. V. Nr. 24** date 21.03.2025 "Për dhënien në perdorim te sipërfaqes prej 7.54 HA në fondin pyjor/ kullosor, per instalimin e paneleve me energji diellore fotovoltaike."

Alfredi Gjata:: Ky projektvendim eshte kaluar disa here, jane bere konsultime dhe per shkak se nuk esht eplitesuar kuorumi eshte shtyre. Hapet votimi: 11 pro, 1 kunder, 0 abstenim

Kemi dhe nje projektvendim tjeter, i cili ka ardhur me vonese, **Nr. 43**, meqenese vijne te dyja nga sektori i pyjeve, e kalojme tani.

Orgest Cenolli: Se bashku me raportin teknik kemi paraqitur edhe nje harte per vendndodhjen e ketyre kullave eolike. Keto ndodhen ne afersi te Vernikut dhe afer Trenit.

Oliver Mulla: Cfare perfitime ka Bashkia ne kete rast?

Vladimir Kello: Ketu nuk eshte paraqitur asgje qe ne te mund te votojme. Gjithesesi duhet te jete dhe raporti teknik per te pare gjeneratorer te cilet perdoren per keto kulla. Nuk ka keshilltar qe mos te kete bere vizatim teknik. Duhen paraqitur detaje, keshtu qe mua me duket e papranueshme te vazhdohet diskutimi.

Orgest Cenolli: Keto kulla ndodhen jashte qendrave te banuara, vendosur ne lartesi te madhe, per arritur efektivitet me te madh. Largesia mes njera tjetres u zgjodh te jete 3-4km. Aktualisht jemi ne fazen e 2-te, pasi fazen e pare ju e keni miratuar si keshill prej 12 kullash. Ndersa subjekti kerkoi perseri siperfaqe. Nje kulle ze afersisht 500m ose 0.05 HA dhe gjithsej si siperfaqe kerkohet 0.65 HA.

Oliver Mulla: Sa te ardhura merr Bashkia nga keto?

Orgest Cenolli: 5 milion e 700 mije leke te ardhura ne vit, ku vlera e perdorimit te tyre eshte diku te 59180 ne total ku eshte perllogaritur dhe rruga dhe vlera e kullotjes dhe vleresime te tjera qe mund te kete pozicionimi i tyre.

Vladimir Kello: Duhen te paraqiten kushte teknike, te cilat lejojne ngritjen e ketyre lloj gjeneratoreve, si largesia nga rruga, mjekohesisht dhe nga qendrat e banuara, apo parqe apo zona te tjera. Une kerkoj qe te shtyhet per mbledhjen e ardhshme.

Salle vjen keshilltari Trifon Meraku.

Hapet votimi: 12 pro 1 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 35** data 23.06.2025 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën ekonomike per muajin Maj 2025"

Nuk ka diskutime per kete projektvendim

Hapet votimi: 13 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr.36** date 23.06.2025 "Miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028."

Aurela Furxhi: Kjo eshte faza e pare, qe ne kemi miratuar tavanet fillimisht, kemi miratuar burimin e te arshurave dhe tani behet shperndarja e te gjitha te ardhurave. Ne kemi derguar dhe ne Ministrine e Financave brenda afateve, kemi mare dhe rekomandimet e tyre dhe ne kete moment ne miratojme fazen e pare. Perllogaritja per nivelin e pagave eshte bere ne baze te pagave qe kemi aktualisht. Gjithashtu edhe shpenzimeve. Nuk kemi shpenzime jashte planit 2025. Me i rendesishem eshte plani i investimeve, te cilat per 2026-2027 ne planifikojme permiresimin e kushteve te banimit qe e kemi bashkefinancim me Ministrine e Financave. Gjithashtu kemi mbarimin e rruges Dobranj-Bracanj, kemi dhe financimin e rrugeve te qytetit Bilisht. Nuk kemi projekt te ri per financim kete vit.

Vladimir Kello: Kush eshte zeri kryesor per te ardhurat e Bashkise?

Aurela Furxhi: Taksat

Eduard Duro: Mendoj qe ne 2026 zeri kryesor i te ardhurave do te jete qiradhenia e tokave.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 1 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 37** date 24.05.2025 "Rishikimin e buxhetit të vitit 2025."

Aurela Furxhi: Brenda dates 30 Qershor behet rishikimi i buxhetit ne baze te kerkesave qe jane paraqitur ne drejtorine time. Keto jane zera qe kane dale si prioritet apo vleresim per tu financuar. Kemi nje bashkefinancim te ri per investimin e shkolles se mesme "Fuat Babani" 34 milion dhe ne kemi deri 15% te shumes te plote te projektit.

Eduard Duro: Nje nderhyrje, nderrimi i gjithe dyerve te brendshme, rehabilitimi i tualeteve te shkolles, kaldajes dhe terreneve sportive.

Aurela Furxhi: Kemi projektin e Dritero Agollit dhe per cerdhen na duhen 4 shtreter, prandaj po kerkoj shtese, qe te kete ndryshime ne kete projektvendim.

Vladimir Kello: Z. Kryetar ne mos gaboj u perurua fillimi i muzeut, i punimeve. Une e ndiej veten i ofenduar sepse Driteroi esht enjeri i nderuar per te gjithe, aq me shume per Devollinjte dhe une do kisha kenaqesine me te madhe qe te merrja pjese si keshilltar.

Eduard Duro: Hapja e punimeve per muzeun ishte nje ceremoni modeste, ku ftuam

vetem deputetet e 2 kraheve politike dhe drejtuesit e institucioneve ne qark. Kur inaugurohet perfundimisht do behet ceremoni e madhe.

Hapet votimi: 13 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 38** date 24.06.2025 "Miratimin e raportit te konsoliduar te Bashkisë Devoll."

Aurela Furxhi: Ne kete raport Bashkia ka te drejte ti ofroje keshillit pasqyrat financiare dhe zbatimin e buxhetit te vitit te shkuar. Ne raport une kam permbledhur analizen e pasyrave financiare, qe kam mare per baze bilancin per tju dhene nje informacion se cfare ndodh ne institucionin tone. Pjesen e dyte kam bere nje permbledhje te zbatimit te buxhetit te vitit 2024, si i kam arritur shifrat per realizim dhe pjesen e 3-te kam mare permbledhjen e detyrimeve per te njohur ato te bashkise Devoll. Keto jane te sqaruara ze per ze.

Hapet votimi: 13 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 39** date 24.06.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në taksën e ndikimit në infrastrukturë."

Gazmend Malo: Preket pika 2 e paketes fiskale te vitit 2025 e cila eshte vendim i Dhjetorit por per efekte zgjedhore nuk na lejohej te benim ndryshime. Eshte vetem pjesa e investimeve ne sektorin bujqesor dhe blegtoral nga 3% te vleres te investimit ne 1%.

Hapet votimi: 13 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 40** date 23.06.2025 " Për miratimin e ndihmes financiare per perballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi rezerve i Bashkisë per qytetarët ne nevojë. (Z.Anesti Pecani)"

Ky projektvendim nuk ka diskutime.

Hapet votimi 13 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 41** date 24.06.2025 " Për miratimin e perfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim."

Elda Zyka: Duke qene se kerkesat do te jene te hapura gjate gjithe vitit, ne bashke me komisionin e strehimit pame te arsyeshme 2 dosje qe kishin dokumentacion te rregullt per tu futur ne keshill.

Eduard Duro: Kemi bere thirrje publike ne web-in zyrtar pasi ne na intereson te kete sa me shume aplikime sepse duam qe ti plotesojme keto kerkesa. Eshte mundesi e mire per cifte te reja por dhe per banore te cilet nuk kane mundesi.

Hapet votimi 13 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me projektvendimin **Nr. 42** date 24.06.2025 "Për miratimin e listes qe do të trajtohen me subvencionim qiraje për vitin 2025"

Hapet votimi: 13 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Kemi nje aplikim per nivel te ri , te tarifave te shoqerise rajonale ujesjelles kanalizime Korce.
Per kete keshilltaret jane plotesisht te gjithe kunder dhe nuk duan as ta diskutojne me gjate , duke thene se kane marre nje vendim per mosmiratim te ketij propozimi .
Alfredi Gjata: Kemi nje kerkese per raportim te kerkuar nga aleanca e grave (sektori pergjegjes sqaron ne lidhje me kete pike .)
Gjithashtu kemi dhe nje propozim per kthimin e godines se vjeter te ish komunes ne fshatin Miras ne muze-lokal.
Vladimir Kello: Un jam pro ketij propozimi . Banoret e fshatit Miras jane me kulture te gjere e koncept qytetar , ky propozim do te shqyrtohet nga Kryetari i Bashkise.
Trifon Meraku: Kam nje propozim per dy figurat e rrethit Devoll, i pari Maqo Lakrori dhe i dyti eshte Ridvan Bode , do ishte ne nderin tone qe keta dy figura ti vleresonim
Eduard duro:kjo eshte nje procedure e gjate pasi duhet te kalojne disa faza duhet te kesh nje liste propozuesish per secilin.

(Lihet per diskutim dokumentacioni dhe procedurash)

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

SEKRETARI I KESHILLIT

Kostandina Braholli

KRYETARI I KESHILLIT

ALFREDI GJATA